REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr 6835/2 Prot

Lushnje, më 15 /08 /2025

RELACION PËRFUNDIMTAR

KËSHILLIT BASHKIAK
Këtu

"PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL VENDOR 2025-2028 BASHKIA LUSHNJE "

Plani Social Vendor i Bashkisë Lushnje për periudhën 2025–2028 është një dokument strategjik trevjeçar, i hartuar në përputhje me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përfshirjes sociale të të gjithë qytetarëve.
Plani fillon me një analizë të gjendjes sociale dhe profileve të riskut, të ndarë sipas njësive administrative të Bashkisë Lushnje. Janë analizuar treguesit kryesorë të varfërisë, shërbimeve sociale dhe strehim.
Dokumenti ka në fokus identifikimin e nevojave të grupeve më të margjinalizuara si: fëmijët në nevojë, gratë viktima të dhunës, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit e vetmuar, komunitetet rome dhe egjiptiane, si dhe familjet në kushte të vështira ekonomike.

Plani përmban:
Objektiva strategjikë për zhvillimin e shërbimeve sociale, përfshirjen dhe barazinë;
Masa konkrete për periudhën 2025–2028, të ndara në fusha prioritare si: nevojat bazë, mbrojtja sociale, punësimi dhe aftësitë, pjesëmarrja dhe të drejtat e njeriut, edukimi dhe shërbimet për PAK;
Një Plan Veprimi të detajuar për çdo vit me tregues matës, burime financiare dhe institucionet përgjegjëse për zbatim;
Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit, për të siguruar transparencë, efektivitet dhe rishikim të vazhdueshëm sipas nevojës.

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Për zbatimin e këtij plani, është parashikuar bashkëpunimi ndërinstitucional me strukturat vendore, institucionet qëndrore, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, duke u mbështetur në buxhetin vendor dhe fonde shtesë të mundshme nga programet kombëtare dhe donatorët.

Ky dokument përbën një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një bashkie më të drejtë, më gjithëpërfshirëse dhe më të ndjeshme ndaj nevojave të të gjithë qytetarëve dhe *ka kaluar në konsultim publik në ambientet e Muzeut Historik Lushnje në datën 15.08.2025 me proces-verbal nr.7018 prot. datë 15.08.2025.*
Gjatë konsultimit u diskutuan mbi përmbajtjen e planit mbi gjithëpërfshirjen, barazinë,etj. Këto diskutime nuk sollën ndryshime në Planin final.

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr6835 Prot

Lushnje, më 08/08/2025

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
Këtu

"PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL VENDOR 2025-2028 BASHKIA LUSHNJE "

Plani Social Vendor i Bashkisë Lushnje për periudhën 2025–2028 është një dokument strategjik trevjeçar, i hartuar në përputhje me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përfshirjes sociale të të gjithë qytetarëve.
Plani fillon me një analizë të gjendjes sociale dhe profileve të riskut, të ndarë sipas njësive administrative të Bashkisë Lushnje. Janë analizuar treguesit kryesorë të varfërisë, shërbimeve sociale dhe strehim.
Dokumenti ka në fokus identifikimin e nevojave të grupeve më të margjinalizuara si: fëmijët në nevojë, gratë viktima të dhunës, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit e vetmuar, komunitetet rome dhe egjiptiane, si dhe familjet në kushte të vështira ekonomike.

Plani përmban:
Objektiva strategjikë për zhvillimin e shërbimeve sociale, përfshirjen dhe barazinë;
Masa konkrete për periudhën 2025–2028, të ndara në fusha prioritare si: nevojat bazë, mbrojtja sociale, punësimi dhe aftësitë, pjesëmarrja dhe të drejtat e njeriut, edukimi dhe shërbimet për PAK;
Një Plan Veprimi të detajuar për çdo vit me tregues matës, burime financiare dhe institucionet përgjegjëse për zbatim;

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit, për të siguruar transparencë, efektivitet dhe rishikim të vazhdueshëm sipas nevojës.

Për zbatimin e këtij plani, është parashikuar bashkëpunimi ndërinstitucional me strukturat vendore, institucionet qëndrore, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, duke u mbështetur në buxhetin vendor dhe fonde shtesë të mundshme nga programet kombëtare dhe donatorët.

Ky dokument përbën një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një bashkie më të drejtë, më gjithëpërfshirëse dhe më të ndjeshme ndaj nevojave të të gjithë qytetarëve.

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr 6835/1 Prot

Lushnje, më 08/08/2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. 74 Datë 08/08/2025

"PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL VENDOR 2025-2028 BASHKIA LUSHNJE "

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8 pika 1, neni 24,neni 54,shkronja "k", Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë",neni 36 shkronja" c"; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2016 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për hartimin e Planit Social Vendor", propozojmë të miratohet nga Këshilli Bashkiak Lushnje, "Plani Social Vendor 2025-2028 Bashkia Lushnje".

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e dokumentit "Plani Social Vendor 2025-2028 Bashkia Lushnje",sipas kërkesave të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligjit nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky Vendimin hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Drejtoria e Shërbimeve Sociale
Anila Çela

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E_mail:bashkia_lushnje@yahoo.com